

Priority Primary Care Centres (Qendra Prioritare të Kujdesit Parësor)

OFFICIAL

Albanian | Shqip

- A keni nevojë të takoni urgjentisht një mjek?
- Priority Primary Care Centres (Qendrat Prioritare të Kujdesit Parësor) ofrojnë trajtim falas për të gjithë personat me dëmtime apo sëmundje urgjente.
- Mjekët e qendrës PPCC do ju ndihmojnë të merrni trajtimin që ju nevojitet, më shpejt se në departamentin e urgjencës së një spitali.
- Ata mund të trajtojnë gjendje të tilla si infeksione të lehta, djegie të vogla, ndrydhje ose kocka të dyshuara për thyerje.
- Nëse keni ndonjë dëmtim apo sëmundje serioze, telefononi Triple Zero (000) (Shërbimin e Urgjencës).
- Nëse nuk keni nevojë për kujdes urgjent, lini një takim me mjekun tuaj të zakonshëm.
- Shërbimet e PPCC përfshijnë patologjinë, radiologjinë dhe farmacinë.
- Shërbimet e PPCC janë falas për të gjithë personat, me apo pa kartën e Medicare.
- Qendrat PPCC janë të hapura me orare të zgjatura, 7 ditë në javë.
- Nuk keni nevojë për takim.
- Qendrat PPCC po hapen në të gjithë Viktorian.
- Për vendndodhjen e qendrave dhe për më shumë informacion, vizitoni Kanalin 'Për një shëndet më të mirë' (në anglisht: Better Health Channel) në faqen: www.betterhealth.vic.gov.au/health/servicesandsupport/priority-primary-care-centres
- Në qendrat PPCC ka përkthyes të disponueshëm. Telefononi Shërbimin Kombëtar të Përkthimit dhe të Interpretimit (në anglisht: Translating and Interpreting Service National, e quajtur ndryshe "TIS National") në numrin e telefonit 131 450.